

UDHËZUES PËR FERMERËT

Merrni mbrapsht 10% nga shitjet tuaja bujqësore

10%

kthim mbrapsht

Si fermer i regjistruar mund të aplikoni vetë, online në eFiling, për kompensimin 10%. Ja gjithçka në një faqe.

A përfitoni ju?

- Jeni fermer i regjistruar**
I regjistruar si prodhues bujqësor.
- Nuk jeni i regjistruar për TVSH**
Skema vlen vetëm jashtë regjimit të TVSH-së.
- Statusi juaj është "aktiv"**
Subjekti juaj tatimor është në gjendje aktive.


Çfarë t'i keni gati

- Kredencialet e eFiling**
NIPT-i dhe fjalëkalimi juaj.
- Logaria bankare**
E regjistruar në eFiling — aty merrni paratë.
- Faturat e shitjeve**
Sistemi i sjell vetë nga periudha.
- Dokumentet shoqëruese**
Çdo dokument që doni të bashkëngjitni.

5 hapat e aplikimit në eFiling


- Hyni në eFiling**
Identifikohuni në llogarinë tuaj në eFiling me NIPT-in dhe fjalëkalimin, pastaj shkoni te menuja "Çështjet e mia".
✓ Pas hyrjes, gjeni hapësirën "Çështjet e mia".

- Krijoni kërkesën**
Shtypni "Krijoni një Çështje të Re" dhe zgjidhni llojin "Kërkesë për rimbursim të fermerëve".



- ✓ Hapet formulari me të dhënat tuaja dhe periudhën 6-mujore.

- Plotësoni formularin**
Zgjidhni faturat që doni të përfshini dhe zgjidhni llogarinë bankare ku doni të merrni paratë (e detyrueshme).




- ✓ Sistemi llogarit vetë Shumën Totale dhe Kompensimin 10%.

- Ngarkoni dokumentet dhe dorëzoni**
Bashkëngjitni dokumentet shoqëruese, pastaj shtypni "Dorëzo Aplikimin për Rimbursim".



- ✓ Sistemi kontrollon afatin, faturat dhe llogarinë para se ta pranojë.

- Ndiqni statusin**
Kërkesa juaj merr statusin "Në proces". Përgjigjen e gjeni te menuja "Të dorëzuara".



- ✓ Sa kohë keni një kërkesë në proces, nuk mund të krijoni një tjetër.

Çfarë ndodh pasi dorëzoni

- Kalon te Drejtoria Rajonale**
Te tatimet e rajonit ku jeni i regjistruar.
- Inspektori verifikon faturat**
Sipas kriterëve ligjore të skemës.
- Miratohet në disa nivele**
Përgjegjësi → Drejtori i Kontrollit → Drejtori Rajonal.
- Merrni përgjigjen**
Aprovuar ose Refuzuar — te "Të dorëzuara".

⚠ Pse mund të bllokohet aplikimi

Shmangni këto gabime të zakonshme:

- ✗ Jeni i regjistruar për TVSH.
- ✗ Statusi juaj nuk është "aktiv".
- ✗ Aplikoni pas afatit të periudhës.
- ✗ Nuk ngarkoni dokumente ose nuk zgjidhni fatura.
- ✗ Nuk zgjidhni llogarinë bankare.
- ✗ Keni tashmë një kërkesë "Në proces".

📄 Për ndihmë, drejtoheni në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve ku jeni i regjistruar.